

KONTRATË SHITJEJE KUOTASH

Hyrje

Sot më datë 15 janar 2023 (“**Data e Nënshkrimit**”), në Tiranë, lidhet kjo Kontratë Shitjeje Kuotash (në vijim “**Marrëveshja**”) mes:

1. Gentian Skënderaj, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, lindur më 27 Qershor 1977 në Berat, Shqipëri, identifikuar me Letërnjoftim ID me numër personal H70627048G;

Helidon Begaj, Helidon Begaj, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, lindur më 18 Shkurt 1978 në Berat, Shqipëri, identifikuar me Letërnjoftim ID me numër personal H80218135W;

Herodjan Terezi, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, lindur më 19 Shkurt 1984 në Tiranë, Shqipëri, identifikuar me Pasaportë me numër personal I40219062K (bashkërisht me Gentian Skënderaj dhe Helidon Begaj referuar në vijim si “**Shitësit**”)


2. Enea Spahiu, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, lindur më 23 Mars 1993 në Burrel, Shqipëri, identifikuar me Letërnjoftim ID me numër personal J35323060E (“**Blerësja**”)

Shitësit dhe Blerësja referohen në vijim bashkërisht si “**Palët**” dhe veçmas si “**Pala**”.

Neni 1. Shitja e Kuotave

- Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësit bashkërisht i shesin Blerëses 10% (dhjetë për qind) të të drejtave të fitimit dhe 7% (shtatë për qind) të të drejtave të votës, në Shoqërinë OTIUM sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Arena Center, Sheshi Italia, Zona BC, Zona Kadastrale 8160, Pasuria Nr 7/5, Tiranë, me NUIS M11615036Q (“**Shoqëria**”), për një çmim prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekësh (“**Çmimi**”). Kjo Kontratë hyn në fuqi në Datën e Nënshkrimit.
- Konkretisht, secili prej Shitësve i shet Blerëses përqindjet e fitimit dhe votës që zotëron në Shoqëri, në masën e mëposhtme:
 - Nga shitësi Gentian Skënderaj, 3% (tri për qind) të të drejtave të fitimit dhe 0% (zero për qind) të të drejtave të votës në Shoqëri;
 - Nga shitësi Helidon Begaj, 4% (katër për qind) të të drejtave të fitimit dhe 3.5% (tri pikë pesë për qind) të të drejtave të votës në Shoqëri;
 - Nga shitësi Herodjan Terezi, 3% (tri për qind) të të drejtave të fitimit dhe 3.5% (tri pikë pesë për qind) të të drejtave të votës në Shoqëri.
- Çmimi i ndahet Shitësve në tri pjesë të barabarta. Çmimi është likuiduar plotësisht dhe privatisht mes Palëve në Datën e Nënshkrimit me para në dorë.

Neni 2. Kuotat në Shoqëri pas Shitjes



Me hyrjen në fuqi të kësaj Kontrate, secila nga Palët do të zotërojë në Shoqëri kuotat në mënyrën e poshtëshënuar:

- (a) Ortaku: Helidon Begaj
Kuota e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë: 30% (tridhjetë për qind)
Pesha e votës në Asamble: 21% (njëzet e një për qind)
Numri i kuotave: 1 (një)
- (b) Ortaku: Gentian Skënderaj
Kuota e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë: 30% (tridhjetë për qind)
Pesha e votës në Asamble: 51% (pesëdhjetë e një për qind)
Numri i kuotave: 1 (një)
- (c) Ortaku: Herodjan Terezi
Kuota e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë: 30% (tridhjetë për qind)
Pesha e votës në Asamble: 21% (njëzet e një për qind)
Numri i kuotave: 1 (një)
- (d) Ortakja: Enea Spahiu
Kuota e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë: 10% (dhjetë për qind)
Pesha e votës në Asamble: 7% (shtatë për qind)
Numri i kuotave: 1 (një)

Neni 3. Marrëveshje të Tjera

Kjo Kontratë nuk shfuqizon asnjë marrëveshje tjetër të lidhur mes Palëve në masën që ajo marrëveshje nuk bie ndesh me dispozitat e kësaj Kontrate. Marrëveshjet e tjera private mes Palëve do të vazhdojnë të jenë të detyrueshme dhe të ekzekutueshme.

Neni 4. Kopjet


Kjo Marrëveshje është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, ku 1 (një) kopje do të mbahet nga Blerësja dhe 1 (një) kopje nga Shitësit.

NË PRANI TË TYRE, Palët ekzekutojnë këtë Kontratë sipas rregullave, në Datën e Nënshkrimit.


PALËT

SHITËSIT


Gentian Skënderaj



Helidon Begaj



Herodjan Terezi



BLERËSJA

Enea Spahiu

